

**VENDIM**  
**Nr.1243, datë 10.9.2008**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E KOHËS SË PUNËS TË PERSONAVE, QË KRYEJNË TRANSPORT RRUGOR, PËR ORËT E DREJTUESVE TË MJETEVE DHE PAJISJET E REGJISTRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 224 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe të neneve 76, pika 2, e 97, pika 1, shkronja “e” të ligjit nr.7961, datë 12.7.1996 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullores për organizimin e kohës së punës të personave, që kryejnë transport rrugor, të lëvizshëm, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Nenet 342 e 343, pikat 2 e 3 të vendimit nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave “Rregullorja në zbatim të Kodit Rrugor”, të ndryshuar, shfuqizohen.

3. Pika 2 e vendimit nr.360, datë 25.3.1996 të Këshillit të Ministrave, “Për rregullimin e kohës së punës dhe të pushimit në ndërmarrjet e transportit automobilistik, hekurudhor, detar dhe ajror, dhe ndërmarrjet, që mirëmbajnë dhe riparojnë mjetet e transportit”, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë rregullore, shfuqizohen.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**